

**MBI AKTIVITETIN  
E KOMISIONIT TË POSAÇËM  
PARLAMENTAR  
DHE ZHVILLIMET NË REFORMËN  
PËR MIRËQEVERISJEN, ANTIKORRUPSIONIN  
DHE SUNDIMIN E LIGJIT**



**KPP – Buletin periodik 03  
Gusht 2024**



**KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR  
“PËR THELLIMIN E REFORMAVE PËR MIRËQEVERISJEN,  
SUNDIMIN E LIGJIT DHE ANTIKORRUPSIONIN  
PËR SHQIPËRINË 2030 NË BASHKIMIN EUROPIAN”**

## Transparenca e veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar dhe informimi i publikut

Një ndër parimet kryesore të punës së Komisionit të Posaçëm Parlamentar është transparenca dhe informimi i publikut në kohë reale për gjithë veprimtarinë e Komisionit. Kjo jo vetëm nëpërmjet publikimit të të gjitha informacioneve në faqen web të Kuvendit, por edhe në përpjekjet që ndërmorëm që në fillim të funksionimit për të krijuar një faqe të ndërlidhur për Komisionin e Posaçëm.

Në përmbushje të parimit të transparencës, por edhe për ta bërë më të lehtë aksesueshmërinë e informacionit dhe në zbatim të vendimit të Komisionit të datës 21 qershor 2024, gjatë muajit gusht është punuar nga Sekretariati Teknik dhe ekspertë të IT-së për ndërtimin e faqes *online* dhe platformës së komunikimit publik. Në këtë hapësirë virtuale do të dokumentohet veprimtaria e Komisionit të Posaçëm, si dhe do të garantohet transparenca publike dhe përfshirja e të gjithë aktorëve dhe faktorëve të rëndësishëm në këtë proces. Faqja do të bëhet funksionale në gjysmën e parë të muajit shtator 2024.

**MASl.al** është konceptuar si një faqe dinamike, që synon të bëjë jo vetëm transparencën e punës së Komisionit të Posaçëm, por të ketë edhe ndërveprim të lartë me publikun dhe përfshirje të personave të ndryshëm që duan të kontribuojnë. Në hapësirën "*Konsultim me publikun*" janë rubrika të veçanta për të pyetur ekspertët, për të zhvilluar anketime të ndryshme dhe për konsultimin e çështjeve e nismave që do të dalin gjatë punës së Komisionit të Posaçëm. Po kështu do të publikohen thirrjet e ndryshme të Komisionit për pjesëmarrjen e grupeve të interesit dhe të publikut në tërësi.

Cilido që është i interesuar të regjistrohet ka një hapësirë të dedikuar për të marrë në mënyrë periodike publikimet dhe përditësimet sipas tri shtyllave kryesore: *mirëqeverisja, antikorrupsioni dhe sundimi i ligjit*.

Dokumentet që krijohen nga puna e Komisionit, të tilla si vendimet e mbledhjeve, procesverbalet dhe raportet e ndryshme që do të përgatiten në vijim të mandatit të Komisionit, gjenden në një hapësirë të veçantë të faqes dhe mund të administrohen nga kushdo.

Në hapësirën "*Media*" janë rubrikat e posaçme të njoftimeve për çdo mbledhje, lajmet dhe deklaratat e Komisionit, galeria e fotove dhe videove si dhe buletinët e çdo muaji, që janë një përmbledhje e veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm.

Publiku ka mundësi të njihet me përbërjen e Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë (GENL) dhe Sekretariatit Teknik (ST) sipas të tri shtyllave të mësipërme, të njihet me partnerët kryesorë të punës së Komisionit, si dhe të aksesojë në hapësirën "*Projekte*" dosjen e plotë të dokumenteve orientuese për punën e ekspertëve. Po aty do të publikohet në vijim edhe Dokumenti Analitik dhe Plani i Veprimit, që do të jenë dy produktet finale të punës së Komisionit të Posaçëm.

"*Pyetje dhe përgjigje*" është një rubrikë e dedikuar për të sqaruar cilindo që është i interesuar të mësojë më tepër rreth qëllimit të Komisionit të Posaçëm, objektivave të tij, mandatit, ndërlidhjen me integrimin europian etj.

## Filloi procesi për hartimin e Dokumentit Analitik

Gjatë muajit gusht Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë dhe ekspertët e Sekretariatit Teknik, të angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit, filluan punën për hartimin e Dokumentit Analitik, i cili synon të paraqesë një vlerësim/analizë të situatës aktuale në fushën e mirëqeverisjes, antikorrupsionit dhe sundimit të ligjit.

Gjatë mesit të muajit gusht dhe në fillim të muajit shtator Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë (GENL) dhe ekspertët e Sekretariatit Teknik u angazhuan për njohjen, skanimin dhe analizën e dokumentacionit të vënë në dispozicion, duke identifikuar vlerësimet, gjetjet, problematikat dhe rekomandimet përkatëse për tri fushat objekt i punës së Komisionit të Posaçëm Parlamentar.

Ekspertët e nivelit të lartë, të organizuar në tre nëngrupe: i) *nëngrupi për mirëqeverisjen*; ii) *nëngrupi për antikorrupsionin*; iii) *nëngrupi për sundimin e ligjit*, janë njohur dhe konsultuar me dokumentet që do të shërbejnë si referenca bazë për hartimin e Dokumentit Analitik, të vëna në dispozicion nga Sekretariati Teknik pranë Komisionit të Posaçëm. Referencat bazë përfshijnë para së gjithash gjetjet, vlerësimet dhe rekomandimet e raportit të progresit për Shqipërinë dhe raportit të shqyrtimit analitik për grupkapitujt I “Themelorët” (raporti *Screening*) të Komisionit Europian; udhërrëfyesin “Për reformën në administratën publike 2023–2030”; “Projektstrategjinë ndërsektoriale kundër korrupsionit 2024–2030”; udhërrëfyesin “Për shtetin e së drejtës”; raporte, gjetje dhe vlerësime të publikuara nga organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në vendin tonë, organizata të ndryshme ndërkombëtare si dhe burime të ndryshme zyrtare nga institucionet e administratës publike.

Volumi i dokumenteve të vëna në dispozicion të ekspertëve është shumë i madh. Konkretisht, *nëngrupit për mirëqeverisjen* do t’i duhet të lexojë e të skanojë mbi 100 dokumente me rreth 5000 faqe, *nëngrupit për antikorrupsionin* do t’i duhet të skanojë dhe analizojë rreth 120 dokumente me rreth 7000 faqe, *nëngrupit për sundimin e ligjit* do t’i duhet të skanojë rreth 90 dokumente me rreth 5000 faqe.

## Takime të grupeve të Ekspertëve të Nivelit të Lartë

Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë (GENL) ka zhvilluar një sërë takimesh periodike gjatë muajit gusht për të diskutuar ecurinë e procesit të analizës dhe programin e mëtejshëm të punës. Veçanërisht në gjysmën e dytë të muajit gusht grupet e ekspertëve, sipas shtyllave, zhvilluan një sërë takimesh midis tyre për organizimin e brendshëm të punës, ndarjen e tyre sipas përvojës që ka secili për të mbuluar komponentë të caktuar etj. Kjo ishte dhe një mundësi e mirë për të dëgjuar mendimet dhe sugjerimet e ekspertëve dhe prezantimin e qasjes së tyre në trajtimin e analizës me gjetjet dhe problematikat përkatëse, veçanërisht për strukturën e Dokumentit Analitik.

Gjatë muajit gusht Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë ka zhvilluar rreth 14 takime për tri shtyllat e Komisionit të Posaçëm Parlamentar.

## Përfshirja e ekspertëve ndërkombëtarë dhe atyre shqiptarë jashtë vendit

Në fund të muajit korrik dhe në fillim të muajit gusht, për të garantuar gjithëpërfshirjen e të gjithë aktorëve ndërkombëtarë, qeveritarë dhe joqeveritarë, si dhe për të përfituar ekspertizën më të mirë të ekspertëve shqiptarë jashtë vendit, u janë dërguar ftesa për pjesëmarrje dhe bashkëpunim 83 aktorëve. Prej tyre gjatë muajit gusht kanë shprehur interesin për të bashkëpunuar dhe kontribuar në reformën për mirëqeverisjen, antikorrupsionin dhe sundimin e ligjit rreth 49 institucione dhe organizata ndërkombëtarë si dhe ekspertë të huaj dhe shqiptarë jashtë vendit, të cilët kanë dorëzuar dokumentacionin përkatës. Dokumentacioni është administruar nga stafi i Komisionit.

15 përfaqësi diplomatike dhe organizata ndërkombëtare me eksperiencë në konsolidimin e demokracisë dhe forcimin e shtetit të së drejtës kanë shprehur interesin për të kontribuar me ekspertizë dhe dokumentacion për të ofruar standartet më të larta dhe praktikat më të mira të vendeve të tjera, duke e konsideruar reformën për mirëqeverisjen, antikorrupsionin dhe sundimin e ligjit tepër të rëndësishme për rrugëtimin e sigurt të Shqipërisë në BE.

Ndërkohë OSBE-ja, Këshilli i Europës, Partneriteti i Qeverisjes së Hapur (OGP), Banka Botërore etj. janë në procesin e përgatitjes së metodologjisë së punës për sigurimin e ekspertizës së nevojshme.

Po ashtu tri universitete prestigjioze në çështjet e së drejtës, të mirëqeverisjes dhe antikorrupsionit, të së drejtës së Bashkimit Europian kanë shprehur gadishmërinë e tyre për të bashkëpunuar institucionalisht me grupin e pedagogëve që do të shërbejnë si konsulentë në këtë proces reformues, si Kolegji i Europës, Akademia Ndërkombëtare Antikorrupsion me qendër në Austri, Universiteti i së Drejtës i Salentos etj.

Gjatë kësaj periudhe një numër pedagogësh (12) nga Universiteti i së Drejtës në Gjermani, në Britani, në Itali, në Austri etj., ekspertë të njohur në këto fusha, kanë shprehur interesin e tyre për të kontribuar me ekspertizën e tyre. Gjithashtu kanë shprehur interes për t'u përfshirë në këtë proces ekspertize në rolin e konsulentit të jashtëm edhe një numër ekspertësh të huaj magjistratë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britania e Madhe, Gjermania, Italia, Kroacia etj.

Deri tani mbi 20 shqiptarë jashtë vendit, pedagogë dhe ekspertë të afirmuar dhe me përvojë në fushën e antikorrupsionit, të së drejtës dhe mirëqeverisjes kanë shprehur interesin për të qenë pjesë e këtij procesi të rëndësishëm për vendin. Grupit të ekspertëve i janë bashkuar edhe një numër pedagogësh shqiptarë, disa prej të cilëve zhvillojnë njohuritë e tyre postdoktorale në universitetet prestigjioze në vendet të ndryshme të BE-së, si në Universitetet e Hollandës (Utrecht, Maastricht), Norvegji (Oslo), Austri (Vjenë), Itali, SHBA, Kanada, Gjermani etj., si dhe ekspertë shqiptarë në fushën e drejtësisë dhe të zbatimit të ligjit nga Spanja, Franca, Belgjika, Kanadaja, Britania, Italia etj.

## Çfarë pritet të ndodhë gjatë muajit shtator me agjendën e Komisionit?

Fokusi kryesor gjatë gjithë muajit shtator do të jetë puna në nëngrupet e ekspertëve për përgatitjen e analizës për të tri shtyllat: i) *mirëqeverisjen*; ii) *antikorrupsionin*; iii) *sundimin e ligjit*. Gjatë muajit gusht ekspertët kanë punuar në mënyrë të pavarur për njohjen me dokumentet e vëna në dispozicion për lexim e skanim dhe identifikimin prej tyre të vlerësimeve, gjetjeve, problematikave dhe rekomandimeve përkatëse për të tria fushat objekt i punës së Komisionit të Posaçëm Parlamentar. Gjatë muajit shtator ekspertët do të punojnë së bashku për të diskutuar rreth gjetjeve të tyre, strukturën e *Dokumentit Analitik* dhe për të filluar hartimin e analizës përkatëse për çdo komponent dhe më pas për harmonizimin brenda shtyllës përkatëse.

Përveç takimeve periodike të Komisionit të Posaçëm gjatë muajit shtator do të zhvillohen takime me përfaqësues të medias për t'i njohur më konkretisht ata me punën e bërë, por edhe për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe për të sqaruar paqartësitë e ndryshme që mund të ketë mbi procesin.

Gjithashtu do të punohet për agjendën e veprimtarive që do të programohen për konsultimin publik, tryezat e debatit me profesionistët e fushës dhe grupet e interesit, për forumet publike *online* dhe ato në rajone dhe qendrat universitare mbështetur në çështjet e identifikuara nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë në projektin e analizës të hartuar prej tyre.

Gjatë muajit shtator, së bashku me drejtuesit e nëngrupeve dhe Sekretariatit Teknik të Komisionit të Posaçëm do të finalizohet puna për metodologjinë për koordinimin e asistencës ndërkombëtare dhe grupit të konsulentëve të jashtëm, me qëllim përfitimin sa më parë të ekspertizës së tyre profesionale.

Komisioni i Posaçëm do të zhvillojë mbledhjet e tij të zakonshme periodike, të fokusuara në aspekte organizative të procesit, si: miratimi i strukturës e përbërjes finale të Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë dhe Sekretariatit Teknik, miratimi i listës së ekspertëve ndërkombëtarë që kanë shprehur interes për të kontribuar si konsulentë të jashtëm, miratimin e ekspertëve përfaqësues të propozuar nga grupet politike parlamentare të opozitës për t'u atashuar pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar - MASI, miratimi i agjendës së aktiviteteteve publike të Komisionit të Posaçëm Parlamentar dhe të Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë për muajin tetor etj.

### **Komisioni i Posaçëm Parlamentar**



## **KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR**

**“PËR THELLIMIN E REFORMAVE PËR MIRËQEVERISJEN,  
SUNDIMIN E LIGJIT DHE ANTIKORRUPSIONIN PËR  
SHQIPËRINË 2030 NË BASHKIMIN EUROPIAN”**